



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE LUSHNJE

Nr. 238 Regj

Lushnje, më 21.02.2022

VENDIM SHPALLJE

(Lidhur me ekzekutimin e "Urdhërit të Ekzekutimit" të titullit ekzekutiv të debitorit)

Unë Endrin Kashari, me detyrë Kryetar i Zyrës Përmbaremore Lushnje, pasi studiova aktet procedurale të çështjes përmbaremore nr. 238, datë 31.01.2022, bazuar në urdhërin e ekzekutimit nr.1411, datë 15.02.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë,

KONSTATOVA:

Se në datë 31.01.2022 është depozituar pranë Zyrës Përmbaremore Lushnje kërkesa e Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Korçë së bashku me Urdhërin e ekzekutimit nr. 1411, datë 15.12.2020 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, me palë:

- Kreditor: Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit Korçë
- Debitor: Ilir Aqif Dalipi
- Objekti: Gjobë administrative

Nga ana e Zyrës Përmbaremore Lushnje ka filluar procedura në bazë të nenit 515 e vijues të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 " *Për Organizimin dhe Funkcionimin e Shërbimit Përmbaremore Gjyqësor*", i ndryshuar për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv të sipërcituar. Nga verifikimi i kryer nga ana jonë në bashkëpunim me organet kompetente rezulton se debitori Ilir Aqif Dalipi nuk ka marr dijeni nëpërmjet shërbimit postar, si rezultat i kësaj, bazuar në nenet 133/a, 133/b, 144/a dhe nenit 517 të Kodit të Procedurës Civile duhet të bëhet njoftimi me shpallje publike i debitorit lidhur me detyrimin që ka ai ndaj palës kreditore Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit Korçë për ekzekutimin e Urdhërit të ekzekutimit nr. 1411, datë 15.12.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë.

Sa më sipër në mbështetje të nenit 133/a, 133/b, 144/a dhe 517 të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 " *Për Organizimin dhe Funkcionimin e Shërbimit Përmbaremore Gjyqësor*", i ndryshuar,

VENDOSA:

1. Të kryej njoftimin nëpërmjet shpalljes publike me afat 20 (njëzet) ditor (duke marr parasysh edhe komunikimin postar), nga data 21.02.2022 – 14.03.2022 të debitorit Ilir Aqif Dalipi;
2. Ky vendim përpilohet në pesë kopje, ku një kopje afishohet në vëndbanimin e fundit të palës debitore , një kopje afishohet në këndin e njoftimit të Zyrës Përmbare Lushnje, një kopje dërgohet për afishim në këndin e publikimeve të Bashkisë Lushnje, një kopje dërgohet për afishim në ambjentet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe një kopje dërgohet për publikim në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbaremit Tiranë.
3. Kjo shpallje publike ka vlerën e aktit të njoftimit për palën debitore Ilir Aqif Dalipi me banim në Gjazë, Nj. Ad. Krutje, Bashkia Lushnje;
4. Pala debitore Ilir Aqif Dalipi me banim në Gjazë, Nj. Ad. Krutje, Bashkia Lushnje të paraqitet pranë Zyrës Përmbare Lushnje në lagjen “Çlirimi”, kati i parë, hyrja tek sekretaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe të marr kontakte me përmbaresin gjyqësor të çështjes përmbareme për t’iu vënë në dispozicion aktet e dosjes përmbareme, pasi me kalimin e këtij afati do të vijohet me ekzekutim e detyrueshëm sipas nenit 519 e ne vijim të Kodit të Proçedurës Civile.

U shpall në Lushnje, sot më datë 21.02.2022

KRYETARI I ZYRËS
Endrin Kashari

